



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

633-22-6992-2-2-1/C577

KOMUNA E ISTOGUT, - Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqson z. Gëzim Ademaj, ne cilesinë e Zyrtarit përgjegjës i prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

Dhe

N.T.T "ANDI-S" nga Kërrnina, Komuna e Istogut, me NRB 811229691 të cilën e përfaqëson z. Agim Sylaj (më tej i quajtur "Kyersi i shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar si në vijim:

LOT 4 – TRANSPORTI I NXËNËSVE NGA FSHATRA E NDRYSHME DERI NE – SHF "NDRE MJEDA" Rakosh me numër identifikues: 633-22-6992-577

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **"TRANSPORTI I NXËNËSVE NE RELACIONIN E PERSHKRUAR SI MË LARTË" LOT 4**

<i>Nr. I prokurimit</i>	633-22-6992-2-2-1/C577
"I brendshëm"	633-22-036-2-2-1/C577

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit të sajë dhe përfundon në datën: **05.09.2024**

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë **10** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues, ndërsa afati i skadimit të kontratës është: **24 muaj** pas datës së nënshkrimit të sajë, perkatësisht deri me **01.09.2024**

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: Relacioni Veriq – “**NDRE MJEDA**” RAKOSH

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve Ofertën Financiare e kontraktorit e datës: **03.08.2022** dhe atë: **LOT 4 – TRANSPORTI I NXËNËSVE NGA FSHATRAT E NDRYSHME DERI NE – SHF “NDRE MJEDA” RAKOSH** është **30,00 € per një ditë-transport ditor**

Vlera totale indikative e kontratës për tri Lotet është **8.000,00 € Tetëmijë** Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *Plani për meaxhimin e kontratës*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e

Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Gëzim Ademaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	05.09.2022
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Agim Sylaj
Pozita:	Drejtör
Nënshkrimi:	
Data:	05.09.2022
Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	8.1	Sigurimi i ekzekutimit të kontratës do të bëhet nga kontraktori në një afat prej 25 mujsh, nga data e nënshkrimit të kontratës në vlerë 10% e kontratës.
Sigurimi	9.1	<i>Pjese e dosjes se tenderit</i>
Vonesat e ekzekutimit	14.1	<i>Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise.</i>
Cilësia e furnizimeve	16.2	<i>Artikujt duhet të jenë të kualitetit me specifikat e parapara, bazuar në pershkrimin teknik të ofertës.</i>
Inspektimi dhe testimi	17.2	<i>Menaxheri i kontratës do të jetë Egzon Haxhijaj, Drejtor SHMU "Ndre Mjeda" Rakosh, me vendim nga ZKA-ja Nr. 01/662 datë 05.09..2022 icili do të bëjë implementimin e kontratës dhe planin për menaxhimin e kontratës.</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	<i>Komisioni Komunal, me se paku tri takime</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Ekonomike-Departamenti për çështje ekonomike-Prishtinë

KOMUNA E ISTOGUT				
TITULLI I AKTIVITETIT: TRANSPORTI I NXENESVE NEPER SHKOLLA				
PARAMASA DHE PARALLOGARIA				
Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia e perafert	Cmimi per Njesi
Loto 1	NGA FSHATRAT E NDRYSHME NE SH.F.B.CURRI-ISTOG,			
	Transporti i nxënësve me aftësi të kufizuara në relacionin: fshati Kërrninë-Kovragë-Istog dhe anasjelltas(numri i nxënësve 3-por mund të rritet ky numer,Gjatësia 32 km në 2 drejtime)	dite	368	
Loto 2	NGA FSHATRAT E NDRYSHME NE SH.F.B.CURRI-ISTOG,			
	Transporti i nxënësve në relacionin: fshati Mojstir-Syne-sh.f,Bajram Curri-Istog dhe anasjelltas.nenkupton 2 drrime,kl.1-5 jane 26 nxënës dhe 6-9 janë 14 nxënës (28km dy drejtime-,si dhe dy ndrrime,dmth 2 ardhje-vajtje,per te dy ndrrimet 40 nxënës perafersisht-ky nr.mund të ndryshoj)	dite	368	
Loto 3	NGA FSHATRAT E NDRYSHME NE SH.F.TREPÇA-BANJE			
	Transporti i nxënësve me aftësi të kufizuara në relacionin: fshati Kosh-sh,f, "Trepça" në Banje dhe anasjelltas.(55.4 km dy drejtime, 1 nxenes)	dite	368	
Loto 4	NGA FSHATRAT E NDRYSHME NE SH.F.NDRE MJEDA RAKOSH			
	Transporti i nxënësve në relacionin: fshati Kërrninë(nisja nga lagja Dani,lagja Metaj) - sh.f. "Ndre Mjeda" ne Rakosh dhe anasjelltas.(16 km dy drejtime, 27 nxënës).	dite	368	30
Loto 5	NGA FSHATRAT E NDRYSHME NE SH.F.NDRE MJEDA RAKOSH			
	Transporti i nxënësve në relacionin: fshati Veriq - Shushicë e Ulët(.Nisja nga lagjeja Hajzeraj,Rrahmanaj, Metaj) - sh.f. "Ndre Mjeda"-Rakosh dhe anasjelltas.(14 km dy drejtime, 20 nxënës).	dite	368	